

Poklek, komuna e Gllgocit/Glogovac, jurist i diplomuar, tre fëmijë)

Muhamet (Ejup) Hajdini

(11.12.1953, shqiptar nga Pokleku i Ri/Novi Poklek, komuna e Gllgocit/Glogovac, elektrikist, tre fëmijë)

Ahmet (Amrush) Berisha

(18.06.1958, shqiptar nga Pokleku i Ri/Novi Poklek, komuna e Gllgocit/Glogovac, punëtor ndërtime, tre fëmijë)

Ferat (Halil) Hoti

(23.03.1959, shqiptar nga Pokleku i Ri/Novi Poklek, komuna e Gllgocit/Glogovac, elektrikist, pesë fëmijë)

Adrian (Hazir) Deliu

(1.05.1980, shqiptar nga Pokleku i Ri/Novi Poklek, komuna e Gllgocit/Glogovac, nxënës)

Fidai (Nazmi) Berisha

(1.05.1980, shqiptar nga Vasileva/Vasiljevo, komuna e Gllgocit/Glogovac, nxënës)

Blerim (Brahim) Shishani

(12.10.1982, shqiptar nga Pokleku i Ri/Novi Poklek, komuna e Gllgocit/Glogovac, nxënës)

Në datën **31.05.1998**, rreth orës 13:00, në **Poklekun e Ri/Novi Poklek** hyri një grup prej më shumë se 100 policësh serb me autoblanda nga drejtimi i fabrikës *Ferronikel* në Gllgoc/Glogovac. Së pari, e rrethuan Poklekun e Ri/Novi Poklek. Më pas, filluan të shtëninë me armë zjarri mbi shtëpitë e fshatit dhe, pastaj, filluan të hynin nëpër shtëpitë dhe t'i nxirrnin njerëz jashtë. Sahitin, Feratin, Blerimin, Seferin, Muhametin, Hajrizin, Ramën dhe Ahmetin i nxorën jashtë me familjarët e tyre, duke i tubuar në rrugën kryesore të fshatit. Jashtë shtëpive u nxorën afro 60 gra, fëmijë dhe burra. Në ndërkohë, një nga gratë e kishte vërejtur një polic të vranë. Aty e sollën edhe Ardianin, tetëmbëdhjetë vjeç, i cili, pas hyrjes së policisë, tentoi që me vëllezër të largoheshin nga fshati; si dhe Fidaiun, i cili në atë mëngjes ishte nisur nga Vasileva/Vasiljevo te mjeku në Gllgoc/Glogovac. Policët i ndanë burrat, ndërkaq grave u urdhëruan që me fëmijët të shkonin në drejtim të fshatit fqinj të Vasilevës/Vasiljevo. Burrave u urdhëruan që të hynin në shtëpinë e Sahitit. Pas

pak, babai i Blerimit, i cili fshihej në një shtëpi që nuk ishte shumë larg të shtëpisë së Sahitit, ka dëgjuar të shtënat e shumta. Pastaj dëgjoji edhe zhurmën e kamionëve. Në orët e vona të mbrëmjes, kur policia u tërhoq nga fshati, Brahimi ka shkuar deri te shtëpia e Sahitit dhe atje e ka gjetur trupin e pajetë të Ardianit. E kishin qëlluar me tre plumba në kokë. Në shtëpinë e Sahitit kishte shumë njolla dhe gjurme gjaku. Por, mungonin trupat e burrave. Familja Deliu e ka varrosur Ardianin në varrezat e Poklekut të Ri/Novi Poklek më 1.06.1998. Në datën 15.06.1998, familjet e burrave të zhdukur e kanë ushtruar një padi penale pranë Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë/Priština, por hetimet lidhur me këtë rast kurrë as që ishin hapur. Familjarët kanë dëgjuar nga shumë njerëz se trupat e Sahitit, Feratit, Blerimit, Saferit, Muhametit, Hajrizit, Ramës, Ahmetit dhe Fidaiut ishin transportuar me kamion në fabrikën e *Ferronikelit*, ku ishin djegur në furrat e kësaj fabrike. Në listën e personave të zhdukur të KNKK-së, rastet e tyre janë të evidentuar me numrat vijues: Sahiti - BLG-803476-01, Ferati - BLG-801959-01, Blerimi - BLG-801851-01, Seferi - BLG-801081-01, Muhameti - BLG-800848-01, Hajrizi - BLG-800848-02, Rama - BLG-802900-01, Ahmeti - BLG-801922-0 dhe Fidaiu - BLG-802084-01.

Burimet: deklarata D.H, FDH-20234; deklarata Z.Q, FDH-20239; deklarata B.S, FDH-202-33; deklarata H.Q, FDH-20236; deklarata F.H, FDH-20235; deklarata X.A, FDH-20238; deklarata A.B, FDH-20232; deklarata N.B, FDH-20237; deklarata H.D, FDH-20243; OSBE KVK, *Gjendja...*, 191, FDH-16916; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 45-47, FDH-23816; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 37-39, FDH-23857; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; HRW, *Shkeljet...*, 42-47, 62, FDH-31132.

Vehbi (Xhemë) Tafa

(3.03.1951, shqiptar nga Carraleva/Crnoljevo, komuna e Shtimes/Štimlje, zdrukthëtar, shtatë fëmijë)

Fehmi (Xhemë) Xhema

(17.02.1953, shqiptar nga Carraleva/Crnoljevo,